VENDIM
Nr.96, datë 14.8.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.79, DATË 26.6.2008 "PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS SË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 9, 26 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 14.8.2008, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave,

VENDOSI:

Në vendimin nr.79, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionereve të ERE-s "Për miratimin e Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifës së Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" bëhen këto ndryshime:

1. Pika 14.1 ndryshohet si vijon:

"14.1 Periudhat rregullatore do të jenë sipas Deklaratës Rregullatore për zbatimin e metodologjive të llogaritjes së tarifave, e cila miratohet nga ERE.".

2. Në pikën 14.6 fjalia e fundit shfuqizohet.

3. Pika 14.7 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta